

Data 05.08.2026

**PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Procedurë e hapur e thjeshtuar - shërbime publike -
prokurim me mjete elektronike**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT: “Supervizion punimesh Përmirësim i sinjalistikës horizontale,
vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Verior LOTI 1 (2026)”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 71247000-
1“Mbikëqyrja e punës së ndërtimit”**

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,568,290.34 (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e
dyqind e nëntëdhjetë pikë tridhjetë e katër) **Lekë, pa TVSH.**

Në bazë të Nenit 21, pika 2 të Ligjit Nr. 16/2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 162/2020
“Për Prokurimin Publik”, Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021
“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor
Autoriteti Rrugor Shqiptar ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e termave
të referencës dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më
poshtë:

Procedura e prokurimit është e parashikuar në Buxhetin e Shtetit për shpenzimet kapitale për vitet
2026-2028 (Shkresa e MIE Nr. 2741/3 prot, datë 15.04.2026).

✓ Në DST është përcaktuar:

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të
përbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të
operatorëve ekonomikë, për të cilën ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të
tjera.

Po

X

Jo



Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspektet kritike, që ndalohet mbështetja:

- Për të provuar përvojën e mëparshme (**shërbime të ngjashme**):
 - Pika 2.3.1 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”
- Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale (**licenca profesionale e shoqërisë për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës**):
 - Pika 2.3.2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”

➤ **Në lidhje me pikën 2.16 të DST-ve argumentojmë:**

Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar se operatorët ekonomikë nuk mund të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera për të provuar përvojën e mëparshme në shërbime të ngjashme (pika 2.3.1) dhe përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, konkretisht licencën profesionale të shoqërisë (pika 2.3.2), pasi këto përbëjnë aspekte kritike të realizimit të kontratës.

Objekti i kësaj procedure është mbikëqyrja e punimeve të sinjalistikës, shërbim i cili kërkon përgjegjësi të drejtpërdrejtë profesionale, teknike dhe ligjore nga subjekti që do të kryejë mbikëqyrjen. Përvoja në shërbime të ngjashme dhe licenca profesionale janë elementë thelbësorë që garantojnë se operatori ekonomik disponon ekspertizën, organizimin dhe kapacitetin e nevojshëm për të monitoruar cilësinë e punimeve, zbatimin e projektit, respektimin e standardeve teknike, të legjislacionit në fuqi, si dhe administrimin korrekt të kontratës së mbikëqyrjes.

Lejimi i mbështetjes në kapacitetet e subjekteve të treta për këto kritere do të cenonte sigurinë se operatori që lidh kontratën disponon realisht kapacitetet profesionale dhe eksperiencën e kërkuar për realizimin e shërbimit, duke rritur riskun për mospërbushje cilësore të detyrimeve kontraktore.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar se përvoja e ngjashme dhe licenca profesionale duhet të zotërohen nga vetë operatori ekonomik, ose në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, nga anëtari që do të realizojë pjesën përkatëse të shërbimit, në përputhje me dispozitat e legjislacionit të prokurimit publik që lejojnë përcaktimin e detyrave ose aspekteve kritike të kontratës që duhet të përmbushen drejtpërdrejt nga kontraktori.

✓ Në DST është përcaktuar:

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A)¹ **Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X**

Sipas rëndësisë:

Çmimi ☐ **pikët 50**

Propozimi Teknik ☐ **pikët 50**

Vlerësimi i Propozimeve Ekonomik kryhet sipas formulës së mëposhtme:

Pe - Pikët për Propozimin Ekonomik

Çu - Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç - Çmimi Ofertues i Radhës (duke filluar nga çmimi më i ulët)

$$Pe = 100 \times \frac{\text{Çu}}{\text{Ç}}$$

(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 8 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024)

Vlerësimi i Propozimeve Teknike kryhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

Kriteret e Vlerësimit

Pikët

(i) **Përvoja për Shërbime të Ngjashme të Konsulentit** **[0-10]**

Nënkriteret

i/a Përvoja për shërbime të ngjashme **40-80%**

Operatorët ekonomikë, të vlerësohen sipas kontratave të sukseshme të ngjashme me objektin e prokurimit.

i/b. Kapaciteti ekonomik dhe certifikatat e standardeve të cilësisë **10-20%**

Operatorët ekonomikë të vlerësohen sipas kapacitetit ekonomik dhe certifikatave të standardeve të cilësisë së paraqitur në ofertë.

¹ Shënim. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, kriter për shpalljen e ofertës fituese do të jetë “oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto”, ku çmimi do të ketë 20 pikë dhe propozimi teknik 80 pikë.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.

(ii) Metodologjia e Propozuar [20-30]
Nënkriteret

ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia	[20-30%]
ii.b Plani i punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit	[30-40%]
ii.c. Organizimi i Stafit	[20-30%]

ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia: Konsulenti duhet të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përqasjen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme, duke përfutur rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve. Konsulenti duhet të paraqesë problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përqasjen teknike që do të adaptojë për zgjidhjen e tyre. Konsulenti duhet të shpjegojë metodologjinë që propozon të adoptojë dhe të paraqesë kompatibilitetin e këtyre metodologjive me përqasjen e propozuar (konsulenti në këtë rast nuk duhet të përsërisë/kopjojë Termat e Referencës).

ii/b. Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit: Konsulenti duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përqasjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e Termave të Referencës në plan pune konkret. Një listë e dokumentave përfundimtare përfshirë raportet, vizatimet dhe tabelat të cilat duhen dorëzuar, duhet përfshirë në këtë kapitull.

ii/c. Organizimi dhe Staf: Konsulenti duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e skuadrës së tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomiko-administrativ.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit sipas nënkritereve të mësipërme.

(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar [20-50]

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

a- Kualifikim i përgjithshëm	[5-20%]
b- Eksperienca në fushën përkatëse	[30-80 %]

- Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës.

- Eksperienca në fushën përkatëse përfshin: eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.

(iv) Transferimin e Njohurive, (nëse kërkohet) [0-10]

Nëse transferimi i njohurive nuk aplikohet (nuk kërkohet), atëherë pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e këtij kriteri duhet t'i shtohen kriterit “Kualifikimet e Stafit kryesor të propozuar”.

Vlerësimi përfundimtar

Peshat për Propozimet Teknike dhe Financiare janë dhënë si më poshtë:

Pesha për Propozimin Teknik: $X = (\text{pikët e propozimit teknik} \times 0.5)$

Pesha për Propozimin Ekonomik: $Y = (\text{pikët e propozimit ekonomik} \times 0.5)$

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është si më poshtë:

Oferta më e mirë = $X + Y$

Argumentimi:

Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar si kriter përzgjedhjeje **“Ofertën ekonomikisht më të favorshme, bazuar në kosto”**, duke vlerësuar ofertat mbi bazën e kombinimit të cilësisë teknike dhe ofertës ekonomike, me peshë **50% për Propozimin Teknik dhe 50% për Propozimin Ekonomik**.

Ky kriter është përzgjedhur duke marrë në konsideratë natyrën e kontratës, e cila ka si objekt shërbimin e mbikëqyrjes së punimeve të sinjalistikës. Ky është një shërbim intelektual dhe profesional, ku cilësia e realizimit të shërbimit ndikon drejtpërdrejt në kontrollin e cilësisë së punimeve, respektimin e projektit, afateve kontraktore, standardeve teknike dhe legjislacionit në fuqi. Për këtë arsye, përzgjedhja nuk mund të bazohet vetëm në çmimin më të ulët, por duhet të garantojë edhe nivelin e kërkuar të ekspertizës teknike.

Kriteret e vlerësimit teknik janë ndërtuar në mënyrë që të identifikojnë ofertën që paraqet kapacitetin më të mirë për realizimin e kontratës, duke vlerësuar:

- përvojën e operatorit ekonomik në realizimin e shërbimeve të ngjashme, si tregues i aftësisë për të përballuar kontrata me kompleksitet të ngjashëm;

- metodologjinë e propozuar, përjasjen teknike, planin e punës dhe organizimin e shërbimit, të cilat demonstrojnë kuptimin e objektit të kontratës dhe mënyrën e organizimit të mbikëqyrjes;
- kualifikimet dhe eksperiencën e stafit kryesor të propozuar, duke qenë se realizimi i kontratës mbështetet në mënyrë të drejtpërdrejtë në ekspertizën profesionale të inxhinierëve dhe specialistëve që do të angazhohen.

Shpërndarja e pikëve ndërmjet nënkritereve është bërë në mënyrë proporcionale me rëndësinë që secili element ka në realizimin me sukses të shërbimit të mbikëqyrjes. Në veçanti, peshë të konsiderueshme i është dhënë metodologjisë së zbatimit dhe kualifikimit të stafit, pasi këto elemente ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e kontrollit teknik të punimeve, menaxhimin e situatave të paparashikuara gjatë zbatimit të kontratës dhe garantimin e interesit publik.

Formula e vlerësimit siguron një ekuilibër ndërmjet cilësisë dhe kostos, duke mundësuar përzgjedhjen e ofertës që ofron raportin më të mirë cilësi-çmim, në përputhje me parimet e transparencës, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe përdorimit me efektivitet të fondeve publike.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10;*
- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit, sipas Shtojcës 2;*

Argumentimi:

Autoriteti Kontraktor ka parashikuar në DST paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Sigurimit të Ofertës, Formularit të Ofertës dhe Listës së Çmimeve sipas shtojcave përkatëse të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Megjithëse Formulari i Ofertës dhe Lista e Çmimeve janë pjesë përbërëse e DST-ve, përfshirja e tyre në këtë pikë është bërë për qëllime qartësie, transparence dhe administrimi korrekt të procedurës, me synim evidentimin e dokumenteve kryesore që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë në momentin e dorëzimit të ofertës.

Kjo mënyrë formulimi nuk shton kërkesa të reja kualifikimi dhe nuk krijon barrierë për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, por shërben vetëm për të rikujtuar detyrimin për paraqitjen

e dokumenteve të domosdoshme që garantojnë vlefshmërinë, krahasueshmërinë dhe vlerësimin korrekt të ofertave.

Përvoja e Autoritetit Kontraktor në administrimin e procedurave të prokurimit ka evidentuar raste të mosparaqitjes ose paraqitjes së paplotë të këtyre dokumenteve nga operatorët ekonomikë, çka ka sjellë vështirësi në procesin e vlerësimit të ofertave.

Për këtë arsye, evidentimi i tyre në mënyrë të veçantë synon vetëm garantimin e paraqitjes së plotë të dokumentacionit të ofertës dhe zhvillimin normal të procedurës së prokurimit.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: sipas Shtojcës 10

Argumentimi:

Kërkesa për paraqitjen e kapacitetit profesional sipas Shtojcës 10 është përcaktuar në mbështetje të Nenit 77, pika 1, shkronja “a” dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe Nenit 41, pika 4 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Përmes Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, operatori ekonomik deklaron përmbushjen e kërkesave që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë profesionale, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Kjo kërkesë i shërben verifikimit paraprak të aftësisë profesionale të operatorëve ekonomikë për të ushtruar ligjërisht aktivitetin objekt prokurimi dhe është në përputhje me natyrën e kontratës dhe kërkesat e legjislacionit të prokurimit publik.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, 2025** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të **jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.**

Argumentimi:

Kërkesa është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Duke qenë se procedura është "*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*", e cila zhvillohet nën kufirin e ulët monetar, vlera e xhiros minimale është përcaktuar në masën 40% të vlerës së fondit limit, në përputhje me kufirin maksimal të lejuar nga legjislacioni në fuqi. Kjo kërkesë është proporcionale me natyrën dhe vlerën e kontratës së shërbimit dhe synon të provojë se operatori ekonomik disponon kapacitetin ekonomik dhe financiar të nevojshëm për realizimin e kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të ketë realizuar shërbime të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë totale **jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit të kësaj kontrate.**

Për të provuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Për kontratat e realizuara me entet publike, vërtetime të lëshuara nga autoriteti/enti kontraktor që vërtetojnë përmbushjen me sukses të kontratës, ku të evidentohen objekti, vlera dhe periudha e realizimit, si dhe faturat tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore.
- b) Për kontratat e realizuara me subjektet private, faturat tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, nga të cilat të evidentohen objekti, vlera dhe periudha e realizimit të shërbimeve.

Argumentimi:

Ky kriter është vendosur në mbështetje të *nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe dispozitave përkatëse të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar*. Kërkesa për realizimin e shërbimeve të ngjashme synon të provojë se operatori ekonomik zotëron përvojën profesionale dhe teknike të nevojshme për të realizuar me cilësi shërbimet objekt prokurimi. Vlera e kërkuar prej 20% të fondit limit është në raport të drejtë me natyrën, kompleksitetin dhe vlerën e kontratës dhe respekton parimin e proporcionalitetit, duke mos kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurë.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale të vlefshme për mbikëqyrjen e punimeve të zbatimit në ndërtim, të lëshuar në përputhje me VKM Nr. 759, datë 12.11.2014 "*Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim*", ndryshuar me VKM Nr. 267, datë 02.05.2024.

Licenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me shërbimin e mbikëqyrjes së punimeve duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Nr.	Licenca	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	NP-11	Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve, linja të TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë
2	NP-12	Punime të inxhinierisë së mjedisit
3	NS-6	Sinjalistika rrugore jondricuese
4	NS-7	Barriera dhe mbrojtja rrugore
5	NS-18	Punime topogjeodezike

Argumentimi:

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 759, datë 12.11.2014 "Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim", i ndryshuar.

Kërkesa për disponimin e licencës profesionale me kategoritë **NP-11, NP-12, NS-6, NS-7 dhe NS-18** është vendosur në funksion të objektit të kontratës dhe në përputhje me kategoritë e punimeve të parashikuara në kontratën e zbatimit të punimeve **"Përmirësim i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Verior"**, për të cilën do të ofrohet shërbimi i mbikëqyrjes. Kategoritë e licencës së kërkuar për operatorin ekonomik që do të realizojë shërbimin e supervizionit korrespondojnë me kategoritë e licencës së kërkuara në procedurën e prokurimit për zbatimin e punimeve, duke garantuar që mbikëqyrja të kryhet nga një subjekt i licencuar dhe kompetent për të gjitha kategoritë e punimeve objekt kontrate.

Kriteri është në përputhje me natyrën, kompleksitetin dhe përmasat e kontratës, respekton parimin e proporcionalitetit dhe synon të sigurojë realizimin e një mbikëqyrjeje profesionale, efektive dhe në përputhje me kërkesat teknike dhe ligjore në fuqi.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë një numër minimal prej **5 (pesë) punonjësish**, të nevojshëm për realizimin e shërbimit objekt prokurimi.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë disponimin e numrit minimal të punonjësve për muajin **Qershor 2026**, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 10 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Në zbatim të *nenit 82 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik"*, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon operatorit ekonomik të renditur i pari paraqitjen e dokumenteve provuese, në origjinal ose kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore ose institucioni kompetent, sipas legjislacionit në fuqi, ku të evidentohet numri i punonjësve për muajin **Qershor 2026**;
- Listëpagesat e punonjësve për muajin **Qershor 2026**, sipas formatit të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Argumentimi:

Ky kriter është vendosur në mbështetje të *nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik"*, i ndryshuar, si dhe të *VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, e ndryshuar.

Kërkesa për disponimin e një numri minimal prej **5 (pesë) punonjësish** synon të garantojë se operatori ekonomik ka kapacitetin organizativ dhe burimet njerëzore të nevojshme për realizimin e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Numri i kërkuar është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën e shërbimit, nevojën për mbikëqyrje të vazhdueshme në terren, koordinimin teknik dhe administrativ të kontratës, si dhe kompleksitetin e punimeve që do të mbikëqyren. Kriteri është proporcional me objektin dhe vlerën e kontratës dhe nuk krijon kufizime të pajustificuara për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin mbikëqyrës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

1. Drejtuesin e projektit duhet të jetë Inxhinier Ndërtimi me licencë dhe me eksperiencë pune në mbikëqyrje, i cili mban përgjegjësi për zbatimin e projektit sipas kushteve teknike të zbatimit, ndjek e miraton cilësinë e punimeve si dhe veprat e artit nga pikëpamja strukturore; miraton materialet dhe volumet e punimeve, certifikatën e pagesës, mbajtjen, kontrollin dhe miratimin e gjithë dokumentacionit, miratimin e ndryshimeve të volumeve, korrespondencën me ARRSH.

2. Mbikëqyrësin për punimet e sinjalistikës e të sigurisë rrugore, i cili duhet të jetë Inxhinier Mekanik me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë. Ai miraton materialet dhe cilësinë e tyre dhe ndjek e miraton cilësinë e punimeve të sinjalistikës horizontale e vertikale (të përkohshme dhe të përhershme), si dhe sigurinë rrugore, gjatë kryerjes së punimeve dhe pas tyre.

3. Mbikëqyrësin për punimet e mjedisit, që duhet të jetë Inxhinier Mjedisi me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë.

4. Mbikëqyrësin për punimet topografike, që duhet të jetë Inxhinier Topograf / Gjeodet / Markshajde me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë, i cili kontrollon dhe miraton volumet, piktetimet dhe kuotëzimin e objektit.

5. Mbikëqyrësin për punimet elektrike, i cili duhet të jetë **Inxhinier Elektrik** me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë. Ai mbikëqyr zbatimin e punimeve elektrike që lidhen me furnizimin me energji të elementëve të sinjalistikës dhe pajisjeve rrugore, kontrollon cilësinë e materialeve dhe pajisjeve elektrike, verifikon përputhshmërinë e punimeve me projektin, specifikimet teknike dhe standardet në fuqi, si dhe ndjek realizimin e provave dhe testeve të funksionimit të instalimeve elektrike.

*** *Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të specifikojë stafin e propozuar duke përshkruar qartë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 10, pikën e kriterit dhe pozicionin që do përmbushi ky staf.*

*** *Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 10. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese".*

Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Licencë për mbikëqyrje punimesh, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

❖ **Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.**

Argumentimi:

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe nenit 41 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, i cili i jep të drejtën autoritetit kontraktor të kërkojë nga operatorët ekonomikë disponimin e personelit kryesor dhe të kualifikuar, kur kjo është e nevojshme për realizimin e kontratës.

Duke qenë se objekti i kësaj procedure është **shërbimi i mbikëqyrjes së punimeve për sinjalistikën e Rajonit Verior**, realizimi i kontratës kërkon angazhimin e një stafi teknik multidisiplinar, me kualifikimet dhe licencat profesionale përkatëse, të aftë për të mbikëqyrur të gjitha kategoritë e punimeve që parashikohen në kontratën e zbatimit.

Për këtë arsye është kërkuar që operatori ekonomik të disponojë:

- **Drejtues Projekti – Inxhinier Ndërtimi**, i cili do të koordinojë dhe administrojë realizimin e kontratës, do të kontrollojë zbatimin e punimeve në përputhje me projektin dhe specifikimet teknike, do të miratojë dokumentacionin teknik, situacionet, certifikatat e pagesës, ndryshimet e volumeve dhe do të sigurojë komunikimin teknik me Autoritetin Kontraktor.
- **Mbikëqyrës për punimet e sinjalistikës dhe sigurisë rrugore – Inxhinier Mekanik**, i cili do të mbikëqyrë cilësinë e materialeve dhe zbatimin e punimeve të sinjalistikës horizontale, vertikale, pajisjeve të sigurisë rrugore dhe elementëve mbrojtës, në përputhje me projektin dhe standardet teknike në fuqi.
- **Mbikëqyrës për punimet e mjedisit – Inxhinier Mjedisi**, i cili do të kontrollojë zbatimin e masave mjedisore të parashikuara në projekt dhe respektimin e kërkesave të legjislacionit mjedisor gjatë realizimit të punimeve.
- **Mbikëqyrës për punimet topografike – Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder**, i cili do të verifikojë piketimet, kuotat, matjet, volumet dhe saktësinë gjeometrike të punimeve në përputhje me projektin e miratuar.
- **Mbikëqyrës për punimet elektrike – Inxhinier Elektrik**, i cili do të mbikëqyrë punimet elektrike që lidhen me objektin e kontratës, do të verifikojë përputhshmërinë e instalimeve elektrike, pajisjeve dhe elementëve elektrikë të sinjalistikës me projektin, specifikimet teknike dhe standardet në fuqi, si dhe do të kontrollojë cilësinë e materialeve dhe funksionalitetin e sistemeve elektrike objekt mbikëqyrjeje.

Kërkesa për disponimin e këtij stafi është vendosur në përputhje me **kategoritë e punimeve të kërkuara në procedurën e prokurimit për zbatimin e punimeve të sinjalistikës së Rajonit Verior**, duke garantuar që shërbimi i mbikëqyrjes të kryhet nga specialistë të licencuar dhe kompetentë për secilën kategori punimesh. Ky kriter është në përputhje me natyrën, kompleksitetin dhe vlerën e kontratës, respekton parimin e proporcionalitetit dhe synon të sigurojë mbikëqyrjen profesionale të punimeve, kontrollin e cilësisë së zbatimit, respektimin e projektit, specifikimeve teknike dhe legjislacionit në fuqi, si dhe mbrojtjen e interesit publik gjatë realizimit të kontratës.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata të vlefshme të sistemeve të menaxhimit, ose ekuivalente, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar, të zbatueshme për objektin e prokurimit, si më poshtë:

- | | |
|-------------------------|---|
| - SSH EN ISO 9001:2015 | <i>Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë</i> |
| - SSH EN ISO 14001:2026 | <i>Sistemet e Menaxhimit Mjedisor</i> |
| - SSH EN ISO 45001:2023 | <i>Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë</i> |

Certifikatat duhet të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar duhet të paraqesë certifikatat për pjesën e kontratës që merr përsipër të realizojë, nëse natyra e pjesës së kontratës e kërkon disponimin e tyre.

Argumentimi:

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe nenit 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, i cili parashikon se autoriteti kontraktor mund të kërkojë paraqitjen e certifikatave të lëshuara nga organe të pavarura për të vërtetuar se operatori ekonomik zbaton standarde të caktuara të sigurimit të cilësisë dhe të menaxhimit mjedisor.

Kërkimi i certifikatave të sipërcituara synon të garantojë që operatori ekonomik disponon sisteme të konsoliduara të menaxhimit të cilësisë, mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit e sigurisë në punë, të cilat janë të domosdoshme për realizimin me standarde profesionale të shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve. Duke qenë se objekti i kontratës lidhet me mbikëqyrjen e punimeve të infrastrukturës rrugore, këto standarde kontribuojnë në sigurimin e cilësisë së shërbimit, respektimin e kërkesave mjedisore dhe zbatimin e praktikave të sigurta gjatë kryerjes së aktivitetit. Kriteri është proporcional me natyrën dhe kompleksitetin e kontratës dhe nuk kufizon konkurrencën, pasi pranohen edhe certifikata ekuivalente të lëshuara nga organe të akredituara sipas legjislacionit në fuqi.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, për procedurat e prokurimit që kanë objekt ofrimin e shërbimeve të supervizionit të punimeve, kërkesat teknike dhe profesionale përcaktohen nëpërmjet **Termave të Referencës**, të cilat përbëjnë dokumentin teknik që përshkruan objektin e shërbimit, qëllimin, fushën e veprimit, detyrat dhe përgjegjësitë e supervizorit, metodologjinë e realizimit të shërbimit, kërkesat për personelin, si dhe rezultatet/dorëzimet që duhet të realizohen gjatë zbatimit të kontratës.

Termat e Referencës janë hartuar duke marrë në konsideratë natyrën, kompleksitetin dhe karakteristikat e punimeve që do të mbikëqyren në kuadër të kontratës **“Supervizion punimesh për sinjalistikën e Rajonit Verior”**, si dhe kërkesat teknike të kontratës së zbatimit të punimeve.

Nëpërmjet Termave të Referencës janë përcaktuar kërkesat minimale të nevojshme për garantimin e realizimit me cilësi të shërbimit të mbikëqyrjes, duke përfshirë:

- objektin dhe qëllimin e shërbimit;
- detyrat dhe përgjegjësitë e stafit mbikëqyrës;
- kërkesat për kualifikimet dhe eksperiencën e personelit;
- mënyrën e raportimit dhe dokumentacionin që duhet të administrohet;
- kontrollin e cilësisë së punimeve, verifikimin e volumeve, materialeve dhe përputhshmërisë me projektin dhe specifikimet teknike të punimeve.

Kërkesat e përcaktuara në Termat e Referencës janë hartuar në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe transparencës, duke siguruar që operatorët ekonomikë të kenë informacion të plotë dhe të qartë mbi objektin e shërbimit dhe detyrimet që duhet të përmbushin, pa krijuar kufizime të pajustificuara për konkurrencën.